

VENDIM
Nr. 434, datë 20.5.2015

**PËR PËRCAKTIMIN E NORMATIVAVE PËR FIROT, HUMBJET, DËMTIMET DHE
SKARCOT GJATË PRODHIMIT, MAGAZINIMIT, TRANSPORTIMIT ETJ., TË
NJOHURA PËR QËLLIME FISKALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “m”, të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Firot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë procesit të prodhimit, magazinimit apo transportimit, për produktet që janë subjekt i akcizës, përcaktohen sipas vendimit nr. 612, datë 5.9.2012 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, të ndryshuar”.

2. Për industrinë prodhuese, që përdorin lëndë djegëse në procesin e prodhimit, normativat e lëndëve të para djegëse përcaktohen sipas vendimit nr. 612, datë 5.9.2012 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, të ndryshuar”.

3. Për duhanin, firot dhe humbjet në procesin e përpunim-manipulimit përllëqariten sipas përcaktimeve të bëra në vendimin nr. 687, datë 18.6.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e nivelit të firove të lejuara gjatë procesit të përpunim-manipulimit të duhanit”.

4. Për humbjet dhe firot në procesin e prodhimit, për të cilat nuk ka akte të veçanta ligjore dhe nënligjore, sasia dhe vlera e lejuar e tyre do të llogariten duke u bazuar në kartat apo skemat teknologjike të procesit të prodhimit. Autoritetet tatimore, gjatë kontrollit të ushtruar në vend pranë tatimpaguesit, analizojnë kartat apo skemat teknologjike të procesit të prodhimit, që shoqërojnë makineritë apo linjat përkatëse nga prodhuesi i tyre dhe kryejnë verifikimet lidhur me nivelin e humbjeve të pësura gjatë procesit të prodhimit/përpunimit. Për matjen e nivelit të humbjeve gjatë prodhimit, inspektorët tatimorë mbajnë procesverbalin përkatës, të firmosur edhe nga drejtuesi teknik apo administratori, të cilin ia bashkëlidhin aktit të kontrollit.

5. Nëse karta teknologjike përcakton norma të amortizimit të makinerive, në varësi të përmbushjes së orëve të punës, atëherë tatimpaguesi, me përmbushjen e këtyre orëve, si pasojë e konsumit apo amortizimit të linjës së prodhimit, duhet të paraqesë një kërkesë për ndryshim të normave të lejuara të humbjeve në prodhim. Kërkesa paraqitet pranë institucioneve përgjegjëse për konfirmimin e kartave teknologjike.

6. Nuk do të njihen firo për transportim apo magazinim, me përjashtim të rasteve të produkteve të akcizës të përcaktuara në vendimin nr. 612, datë 5.9.2012 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, të ndryshuar”.

Për energjinë elektrike, humbje gjatë shpërndarjes së energjisë elektrike do të konsiderohet përqindja e humbjeve të energjisë elektrike e përcaktuar në vendimin nr. 171, datë 25.2.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të rimëkëmbjes financiare të sektorit të energjisë elektrike”.

7. Brenda 45 ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, çdo tatimpagues duhet të paraqesë në Drejtorinë Rajonale Tatimore dokumentacionin për miratimin e firove, ku të përfshihen:

- a) karta teknologjike;
- b) përshkrimi i detajuar i procesit të prodhimit;
- c) planimetria e objektit;
- ç) normativat e konsumit të lëndës së parë dhe të orëve të punës për njësi produkti të gatshëm (karta teknologjike), shoqëruar edhe me të dhënat për:
 - llojin e lëndës së parë, të përdorur në procesin e prodhimit;

-fazat, në procesin teknologjik, ku përdoret lënda e parë.

Karta teknologjike, duhet të jetë e konfirmuar /certifikuar nga një institucioni njohur, që ka aftësinë teknike të konfirmimit të kartave teknologjike, si: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), Instituti i Materialeve të Ndërtimit, Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve, Drejtoria e Patentave dhe Markave, Inspektorati Shtetëror, përgjegjës dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, institucione që miratojnë karta të ndryshme teknologjike apo çdo institucion tjetër që ka aftësitë dhe lidhet me proceset teknologjike përkatëse.

8. Firot e miratuara nga drejtoritë rajonale tatimore (DRT), në përputhje me këtë vendim, do të njihen për efekte fiskale për periudha jo më të hershme se data e miratimit zyrtar në DRT, sipas pikës 7, më lart.

9. Ngarkohen drejtoritë rajonale tatimore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama